

1. Gjëndja shëndetsore dhe trajtimi

Mjeku ju ka shpjeguar gjëndjen shëndetsore në të cilën ndodheni.

Ajo është: _____

Kjo gjëndje shëndetsore kërkon procedurën e lartpërmendur për të kryer diagnostikimin.

Përpara se testi të fillojë, do tju kryhet një EKG (elektrokardigramë) qetësie.

Më pas zemra juaj do të sforcohet duke vënë trupin tuaj në lëvizje me anë të një "treadmill" (tapet lëvizës). Nëse jeni në gjëndje të ecni lehtësisht atëherë mund të ecni mbi një "treadmill". Shpejtësia dhe pjerrësia e tapetit do të ndryshojë me intervale kohe të caktuara. Kjo do të detyrojë zemrën të sforcohet më tepër. Prova do të ndalohet nëse do të ndjeni dhimbje gjoksi, lodheni së tepërmi, ose ndjeni vështirësi në frymëmarrje.

Nëse nuk ndiheni mirë duhet tja komunikoni stafit mjeksor menjëherë.

2. Risqet e Provës Ushtrimore

Kjo procedurë ekzaminuese ka risqe dhe komplikacione të mundshme.

Ato perfshihen por nuk janë të kufizuara tek të mëposhtmet.

Risqe dhe komplikacione të zakonshme (më shumë se 5%) përfshijnë:

- Tharje fyti.
- Marrje fryme.
- Dhimbje muskulare.

Risqe dhe komplikacione të rralla (1-5%) përfshijnë:

- Tension i ulët.

Risqe dhe komplikacione shumë të rralla (më pak se 1%) përfshijnë:

- Dobësi.
- Ritëm kardiak jo normal, i cili vazhdon për një kohë të gjatë. Mund të jetë i nevojshëm elektrosoku për ta korigjuar.
- Mbledhje lëngjesh në mushkri. Mund të keni nevojë për trajtime dhe mjekime të mëtejshme.
- Dhimbje e fortë gjoksi. Mund të keni nevojë për trajtime dhe mjekime të mëtejshme.
- Atak kardiak.
- Vdekja si pasojë e komplikacioneve gjatë kësaj procedure ekzaminuese është jashtëzakonisht shumë e rrallë.

3. Risqet e të moskryerit të kësaj procedure

(Mjeku ti paraqesi në hapsiren e mëposhtme. Të vazhdojnë në kartelën mjeksore nëse është e nevojshme)

4. Konsensusi i pacientit

Pranoj se mjeku më ka shpjeguar;

- Gjëndjen time mjeksore dhe procedurën ekzaminuese të propozuar, duke përfshirë trajtime të mëtejshme nëse mjeku gjen dicka të paparashikuar. Unë i kuptoj risqet, duke përfshirë dhe risqet që janë specifike për mua.
- Procedura/trajtime të tjera të pershtatshme dhe risqet e tyre.
- Prespektivën e gjëndjes time shëndetsore dhe risqet e moskryerjes së kesaj procedure ekzaminuese.
- Unë isha në gjëndje të bëj pyetje dhe të diskutoj me mjekun për gjëndjen time shëndetsore, për procedurën ekzaminuese të propozuar dhe risqet e saj, si dhe për mundësitë e trajtimit. Pyetjet dhe shqetësimet e mia janë diskutuar dhe kanë marrë përgjigje në mënyre të kënaqshme.
- Jam i/e ndërgjegjshëm/e se kam të drejtë të ndryshoj mendje në çdo moment, edhe pasi të kem firmosur këtë formular.
- Jam i/e ndërgjegjshëm/e se gjatë kësaj procedure do të kryhen fotografi ose regjistrime të cilat do të ndihmojnë mjekun në diagnostikimin e gjëndjes time shëndetsore.

5. Deklarata e pacientit

Në bazë të deklaratës së mësipërme, unë kërkoj të kryej procedurën ekzaminuese të lartpërmendur

Emri/Mbiemri: _____

Firma: _____

Data: ____/____/____

6. Deklarata e mjekut

I kam shpjeguar pacientit të gjithë pikat e mësipërme dhe jam i medimit se pacienti /shoqëruesi e kanë kuptuar këtë informacion.

Emri/Mbiemri: _____

Firma: _____

Data: ____/____/____